

Ministri

Znj. Lindita Nikolla lindi në Tiranë, më 22 Tetor 1965. Ajo është e martuar me z. Ligor Nikolla dhe ka një vajzë që quhet Livia.

Znj. Nikolla, në Korrik 2010, ka kryer studimet Master në Administrim Publik, drejtimi Pushtet Ekzekutiv pranë Albanian University dhe në vitin 1989 ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dega Matematikë, Universiteti i Tiranës.

Ajo ka hyrë në politikë në vitin 2003. Gjatë viteve 2003 - 2006 është zgjedhur si Këshilltare e Këshillit të Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë. Është zgjedhur për dy mandate në periudhën 2007- 2011 dhe 2011-2013, Kryetare e Njësisë Bashkiake Nr.1 Tiranë. Në zgjedhjet e 23 Qershorit 2013, zgjidhet deputete e qarkut të Tiranës. Nga shtatori i vitit 2007 znj. Nikolla është anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste.

Në vitin 2006 ka përfunduar Akademinë për Udhëheqësi dhe Reformë pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (NDI) në Tiranë dhe në Qershor të vitit 2008 ka kryer Akademinë mbi Policimin Komunitar dhe Qeverisjen Vendore në Universitetin e Pitsburgut, SHBA. Znj. Nikolla ka kryer gjithashtu një sërë kualifikimesh në menaxhimin e shkollës dhe mësimdhënien e matematikës, si dhe për fuqizimin e gruas në vendimarrje.

Znj. Nikolla zotëron gjuhën angleze dhe njeh gjuhën frënge e atë italiane.

Sekretar i Përgjithshëm

Z. Plarent Ndreca lindi në Rrëshen, Mirditë më 27 Maj 1978. Ai është i martuar dhe ka një djalë, Amantin.

Në vitin 2010 ka kryer studimet Master pranë Universitetit Evropian të Tiranës në degën E Drejtë Publike dhe kursin pasuniversitar për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare. Në vitin 2000 përfundon me sukses studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe ka një karrierë të shkëlqyer në fushën e jurisprudencës.

Karrierën e tij Z. Ndreca e nisi si Asistent Avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë për të kaluar shumë shpejt si avokat i kësaj dhome. Në periudhën 2002-2004 Z. Ndreca ka ushtruar detyrën e Juristit në Degën Juridike dhe të Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Elektrike, Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës. Gjatë viteve 2004-2007 ai punon si Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vitin 2007 ai në bashkëpunim me kolegët e tij krijojnë studion e suksesshme ligjore "T&N" në të cilën ai ishte partner menaxhues.

Z. Ndreca gjithashtu ka kryer një sërë trajnimesh ku vlen të përmendet : "Trajnim i avokatëve shqiptarë mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut" organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Ambasadën Britanike në Shqipëri dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Maj 2008 si dhe "Impakti i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Reformimin e kuadrit ligjor dhe praktikës gjyqësore shqiptare", e organizuar nga Fondacioni Soros në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Dhjetor 2011, në Bari të Italisë.

Z. Ndreca ka spikatur si avokat në mbrojtjen me sukses të disa çështjeve të rëndësishme me ndjeshmëri të lartë publike

Z. Ndreca njeh gjuhën Angleze dhe atë Italiane.